TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

Raporti i auditorit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIME SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE	7 – 45

Deloitte Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

Place of registration: Tirana Court, Decision 16016
VAT (NUIS) No:J62329003N

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionarëve të Tirana International Airport Sh.p.k.:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Tirana International Airport Sh.p.k, bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë proçedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Tirana International Airport Sh.p.k më 31 dhjetor 2013 si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Albanie shpk

21 mars 2014
Tiranë, Shqipëri

Deloitte Albania
Rr.Elbasanit ,Pll. Poshte FAKULTETIT GJEOLOGJI MINIERA
Tirana - Albania
Tel.: +355 4 45 17 920 / Fax : +355 4 45 17 990
NIPT: J62329003N

Elvis Ziu
Partner Angazhimi

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2013
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktivet			
Aktivet afatgjata			
Aktive të trupëzuara, neto	6	181,704,456	263,867,065
Aktive të patrupëzuara, neto	7	7,203,285,280	7,713,805,146
Punime në proces	7	29,069,082	49,446,844
Totali i aktiveve afatgjata		**7,414,058,818**	**8,027,119,055**
Aktivet afatshkurtra			
Parapagim i tatimit mbi fitimin	8	145,688,521	149,670,770
Llogari të arkëtueshme, neto	9	1,728,515,382	2,467,001,167
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	14	-	8,642,994
Tatimi i shtyrë aktiv	23	147,905,787	48,237,506
Aktive të tjera	10	164,261,903	138,912,131
Para në arkë dhe bankë	11	1,862,868,568	1,659,175,026
Totali i aktiveve afatshkurtra		**4,049,240,161**	**4,471,639,594**
Totali i aktiveve		**11,463,298,979**	**12,498,758,649**
Kapitali			
Kapitali themeltar	18	1,161,148,883	1,161,148,883
Diferenca konvertimi		265,569,139	329,091,368
Fitime të mbartura		2,151,694,349	2,632,258,741
Totali i kapitalit		**3,578,412,371**	**4,122,498,992**
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Kredi bankare dhe hua të tjera	12	4,401,350,369	4,888,826,902
Detyrime të tjera	17	583,403,571	663,058,366
Totali i detyrimeve afatgjata		**4,984,753,940**	**5,551,885,268**
Detyrimet afatshkurtra			
Kredi bankare dhe hua të tjera	12	564,784,927	537,802,741
Llogari të pagueshme	13	99,240,137	156,460,394
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	10,432	-
Provigjion për detyrimet koncesionare	15	280,268,526	232,048,414
Tarifa e pagueshme e koncensionit	16	277,447,949	380,872,711
Detyrime të tjera	17	1,678,380,697	1,517,190,129
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**2,900,132,668**	**2,824,374,389**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**11,463,298,979**	**12,498,758,649**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 45, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Shoqërisë Tirana International Airport Sh.p.k më datë 10 mars 2014 dhe u firmosën nga:

Rolf Castro-Vasquez
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Tirana International Airport
Nënë Tereza
Tirana International Airport SHPK
Administrative Building, Rinas, Albania

Suela Keri
Drejtore e Përgjithshme e Financës

TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura	**19**	4,622,127,543	4,467,055,121
Shpenzime personeli	**20**	(442,355,422)	(448,271,229)
Shpenzime provigjoni për detyrimet koncesionare	**15**	(47,233,853)	(41,470,064)
Zhvlerësimi	**6**	(109,431,015)	(122,650,686)
Amortizimi	**7**	(555,752,588)	(550,778,604)
Shpenzim për tarifën e koncesionit	**16**	(291,668,111)	(393,348,163)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	**21**	(973,225,216)	(995,450,425)
Shpenzime financiare, neto	**22**	(1,085,209,318)	(408,607,501)
Fitimi para tatimit		**1,117,252,020**	**1,506,478,449**
Tatimi mbi fitimin	**23**	(145,024,985)	(194,175,879)
Fitimi neto për vitin		**972,227,035**	**1,312,302,570**
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese		(63,522,229)	(13,401,432)
Totali i të ardhurave përmbledhëse		**908,704,806**	**1,298,901,138**

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 45, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Kapitali themeltar	Diferenca konvertimi	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2012	**1,161,148,883**	**342,492,800**	**2,652,457,738**	**4,156,099,421**
Shpërndarja e dividendit	-	-	(1,332,501,567)	**(1,332,501,567)**
Fitimi neto për vitin	-	-	1,312,302,570	**1,312,302,570**
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	**-**
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese	-	(13,401,432)	-	**(13,401,432)**
Gjendja më 31 dhjetor 2012	**1,161,148,883**	**329,091,368**	**2,632,258,741**	**4,122,498,992**
Shpërndarja e dividendit	-	-	(1,452,791,427)	**(1,452,791,427)**
Fitimi neto për vitin	-	-	972,227,035	**972,227,035**
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	**-**
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese	-	(63,522,229)	-	**(63,522,229)**
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**1,161,148,883**	**265,569,139**	**2,151,694,349**	**3,578,412,371**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 45, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese			
Fitimi neto i vitit		**972,227,035**	**1,312,302,570**
Rregullime për:			
Zhvlerësim dhe amortizim	**6, 7**	665,183,603	673,429,290
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve		2,019,378	278,464
Tatimi mbi fitimin	**23**	145,024,985	194,175,879
Shpenzime interesi	**21**	322,375,584	330,718,366
Të ardhura nga interesi	**21**	(26,789,835)	(44,184,209)
Diferenca nga kursi i këmbimit		(24,587,591)	17,601,699
Provigjonimi për llogari të dyshimta	**9**	774,882,752	95,960,132
Shpenzime provigjoni për detyrimet koncesionare	**15**	47,233,853	41,470,064
Ndryshimet në **kapitalin punues:**			
Rritje në llogaritë e arkëtueshme		(38,792,486)	(764,647,695)
Rritje në aktive të tjera		(58,247,748)	(36,690,656)
Rënie në fonde të ngurtësuara në bankë		39,315,000	94,281,000
(Rënie) / rritje në llogaritë e pagueshme		(57,220,258)	57,619,176
Rënie në llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura		8,642,994	487,776
Rritje / (rënie) në llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura		10,432	(291,474)
(Rënie) në tarifën e pagueshme të koncensionit		(103,424,762)	(44,016,630)
Rritje në detyrime të tjera		81,535,773	56,713,591
Paraja neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		**2,749,388,708**	**1,985,207,343**
Tatim fitimi i paguar	**8**	(220,030,035)	(89,545,002)
Interesi i arkëtuar		39,006,828	47,168,008
Paraja e gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		**2,568,365,501**	**1,942,830,349**
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve të patrupëzuara		(14,709,329)	(7,997,294)
Pagesa për punimet në proçes		(40,730,350)	(60,711,654)
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(31,669,043)	(56,458,218)
Paraja e përdorur për veprimtaritë investuese		**(87,108,722)**	**(125,167,166)**
Rrjedhja e parasë nga veprimtaritë financuese			
Pagesa interesi dhe kosto të tjera huamarrjeje		(782,869,931)	(765,708,815)
Shpërndarje dividendi		(1,452,791,427)	(1,332,501,567)
Paraja e përdorur në veprimtaritë financuese		**(2,235,661,358)**	**(2,098,210,382)**
Rritja/ (rënia) neto e parasë në arkë dhe në bankë		**245,595,421**	**(280,547,199)**
Paraja në arkë dhe në bankë më 1 janar	**11**	**1,031,020,026**	**1,313,138,461**
Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në paratë e mbajtura në monedhë të huaj		(2,586,879)	(1,571,236)
Paraja në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor	**11**	**1,274,028,568**	**1,031,020,026**

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 45, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. SHOQËRIA OPERUESE

1.1 Informacion i përgjithshëm

Tirana International Airport Sh.p.k. ("Shoqëria") u krijua në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 20 shtator 2004. Shoqëria është regjistruar me numër regjistri 32147 në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, Shqipëri. Aktiviteti i saj filloi në vitin 2005.

Në momentin e krijimit Shoqëria kishte një kapital prej 1,000,000 Lek të ndarë në 1,000 aksione. Vlera nominale për aksion ishte 1,000 Lek dhe përbërja fillestare e kapitalit ishte si më poshtë:

	Në %
HOCHTIEF Airport GmbH ("HTA")	78.7
Albanian-American Enterprise Fund ("AAEF")	21.3

Në tetor të viti 2004, 31.7% e pronësisë kaloi nga HOCHTIEF Airport Gmbh ("HTA") tek DEG – Deutsche Investitions – und Entwicklungsgesellschaft mbH ("DEG"). Transferimi i pronësisë u regjistrua në Gjykatën e Tiranës në datën 14 tetor 2004 (Vendimi Nr. 32147/1).

Në bazë të vendimit të aksionarëve të datës 25 maj 2005 dhe në përputhje me marrëveshjen e financimit të aksionarëve të datës 5 shkurt 2005, Shoqëria rriti kapitalin e nënshkruar në 414,722,104 Lek (ekuivalent me 3,336,965 Euro). Rritja e kapitalit të nënshkruar u pagua plotësisht nga aksionarët dhe u regjistrua në Gjykatën e Tiranës në datë 19 shtator 2005 (Vendimi Nr. 32147/6).

Bazuar në vendimet e aksionarëve të datave 16 shkurt 2006 (rritja e tretë e kapitalit), 2 gusht 2006 (rritja e katërt) dhe 7 dhjetor 2006 (rritja e pestë) dhe në përputhje me marrëveshjen e aksionarëve datë 5 shkurt 2005, Shoqëria rriti më tej kapitalin e saj përkatësisht me 185,450,895 Lek, 184,566,870 Lek dhe 184,677,450 Lek ekuivalente me një rritje totale prej 4,500,000 Euro. Rritja në kapitalin e nënshkruar është paguar plotësisht prej aksionarëve në fund të vitit 2006.

Në vazhdim, bazuar në vendimin e aksionarëve të datës 27 prill 2007 (rritja e gjashtë e kapitalit) dhe në përputhje me marrëveshjen e aksionarëve të datës 5 shkurt 2005, Shoqëria rriti më tej kapitalin e saj me 191,731,566 Lek (ekuvalent me 1,538,035 Euro). Rritja në kapitalin e nënshkruar është paguar plotësisht prej aksionarëve gjatë vitit 2007.

Bazuar në vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të Hochtief Airport GmbH ("HTA") datë 25 shtator 2013, ky i fundit ndryshoi emrin në AviAlliance GmbH efektive nga data 28 tetor 2013. Vendimi është depozituar ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ("QKR") dhe është reflektuar në ekstraktin e Shoqërisë në datën 30 dhjetor 2013.

Struktura e aksionarëve më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
	Në %	Në %
AviAlliance GmbH (ish HOCHTIEF Airport GmbH ("HTA")	47.0	47.0
DEG – Deutsche Investitions – und Entwicklungsgesellschaft mbH ("DEG")	31.7	31.7
Albanian-American Enterprise Fund ("AAEF")	21.3	21.3

Shoqëria është e vendosur në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas dhe në datën 31 dhjetor 2013 ka 305 punonjës (31 dhjetor 2012: 304 punonjës).

1. SHOQËRIA OPERUESE (VAZHDIM)

1.2 Kontrata e Koncesionit

Përshkrimi i marrëveshjes
Sipas nenit 9 të Ligjit Shqiptar nr. 7973 "Për Koncesionet dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimet Publike dhe të Infrastrukturës" datë 26 korrik 1995 (ndryshuar, sipas Ligjit për Koncesionet"), vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "Për Miratimin e Programit dhe Dokumentacionit të Projektit për Zbatimin e Kontratës së Koncensionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë, datë 5 qershor 2003, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 48 "Për Përzgjedhjen e Ofertuesit të Preferuar për Realizimin e Kontratës së Koncensionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë", datë 27 janar 2004 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave datë 14 tetor 2004, Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqëria lidhën Kontratën e Koncensionit të datës 15 tetor 2004 ("Kontrata e Koncensionit").

Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria lidhën këtë Kontratë me qëllim që të përcaktojnë termat dhe kushtet për të cilat Shoqëria do të gëzojë të drejtat, *inter alia*,

(i) të hartojë, financojë, ndërtojë, të vërë në punë, të operojë, mirëmbajë, të administrojë dhe zhvillojë Terminalin e ri, Objektet e Reja dhe Objektet e Reja Shtesë në Zonën e Koncesionit;
(ii) të përdorë dhe rinovojë Terminalin Ekzistues, Vendndodhjen e Terminalit Ekzistues, Aktivet përkatëse dhe Zonën e Koncensionit;
(iii) të ketë pronësi mbi Objektet e Reja;
(iv) të gëzojë të drejtën e uzufruktit për një periudhë prej të paktën 20 vjetësh në lidhje me Terminalin Ekzistues, Vendndodhjen e Terminalit Ekszistues, aktivet përkatëse dhe Zonën e Koncensionit; si dhe
(v) të lidhë kontrata për blerjen e çfarëdo lloj aktivesh, të përmbushë detyrimet dhe ushtrojë të drejtat sipas kësaj Kontrate.

Koncesioni është dhënë për një periudhë 20 vjeçare duke filluar nga data 23 prill 2005 ("Afati i Koncesionit"). Afati i Koncesionit mund të zgjatet:

(i) ashtu siç është rënë dakort midis palëve (deri në periudhën maksimale ashtu siç parashikohet në Ligj); ose
(ii) për një periudhë që për arsye madhore mund të shtrihet në dy muaj, në përputhje me pikën 24.5 të Zgjatjes së Afatit të Koncensionit për shkak të Forcave Madhore; ose
(iii) për kohën e kërkuar për hyrjen në fuqi të Ndryshimit të Pranueshëm.

Jo më parë se përvjetori i pestë i Datës së Fillimit dhe jo më vonë se 12 muaj përpara përfundimit të Afatit të Koncesionit, secila prej Organizatave Shtetërore të autorizuara dhe Shoqëria mund të fillojë procesin e negocimit lidhur me zgjatjen e periudhës, në formë të shkruar ndaj palës tjetër për të cilën është dhënë fillimisht Koncensioni.

Dorëzimi
Palët bien dakort që në datën e dorëzimit çdo e drejtë përdorimi, që i është dhënë Shoqërisë në lidhje me Zonën e Koncensionit, pajisjet dhe aktivet ekzistuese, duke përfshirë pa kufizim aktivet e marra në dorëzim, duhet të humbasë fuqinë dhe Shoqëria duhet:

(i) t'i transferojë Qeverisë së Shqipërisë çdo të drejtë pronësie që ajo ka mbi pajisjet e reja;
(ii) t'i transferojë Qeverisë së Shqipërisë çdo të drejtë, detyrim dhe përgjegjësi të Shoqërisë lidhur me aktivet në momentin e dorëzimit, Zonën e Koncensionit dhe vetë Koncensionin, përveç dokumentave financiare dhe çdo të drejtë të lidhur me to; dhe

1. SHOQËRIA OPERUESE (VAZHDIM)

1.2 Kontrata e Koncesionit (vazhdim)

Dorëzimi (vazhdim)

(iii) t'i dorëzojë Qeverisë së Shqipërisë çdo dokument që ajo zotëron lidhur me çdo artikull të listuar në pikat e mësipërme (i) dhe (ii) si dhe nuk duhet të mbajë asnjë kopje të tyre; në shkëmbim të pagesës, përveçse kur mbaron Afati i Kontratës (dhe jo kur ajo shfuqizohet), nga ana e Qeverisë së Shqipërisë me një shumë të barabartë me vlerën neto të aktiveve (në datën e dorëzimit, në bazë të Parimeve të Përgjithshme Kontabël të Pranuara në Shqipëri) të Shoqërisë (me përjashtim të Fazës A të Terminalit të Ri dhe Fazës A të Produkteve të Reja Kargo), të rregulluara nga një Ekspert Vlerësimi i Pavarur (i cili merr në konsideratë kushtet e aktiveve përkatëse). Të gjitha taksat dhe shpenzimet e lidhura me proçesin e transferimit dhe shpërndarjes së aktiveve të përmendura në paragrafet (i) dhe (ii) duhet të mbarten nga Shoqëria. Shoqëria duhet të bashkëpunojë dhe të këshillojë Qeverinë e Shqipërisë dhe çdo Ent Shtetëror si p.sh Organizata Shtetërore e Autorizuar për kërkesa të arsyeshme që ato mund të kenë lidhur me nën-paragrafet (i) dhe (ii) të lart-përmendura.

Shoqëria duhet:
(i) të përmbushë dhe të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet që lidhen me detyrimet parësore dhe detyrimet shtesë, në përputhje me Kontratën dhe Praktikat për Industrinë e Mallrave;
(ii) të mos bëjë investime të tjera përveç atyre që kanë lidhje me administrimin e kujdesshëm të parave;
(iii) të mbajë në mënyrë transparente kontabilitetin në përputhje me Parimet e Përgjithshme Kontabël të Pranuara dhe t'i sigurojë Qeverisë së Shqipërisë, më kerkesën e saj, akses në të dhënat dhe analizat e saj lidhur me kostot dhe administrimin si dhe regjistrimet dhe analizat financiare;
(iv) vetëm në rastin kur në Kontratë shprehet ndryshe, ajo duhet të aplikojë, të paguajë, të marrë dhe të mbajë çdo Autorizim të domosdoshëm për kryerjen e detyrimeve të saj lidhur me Kontratën;
(v) të sigurojë që të gjitha zhvillimet në Zonën e Koncensionit i referohen, në bazë të rregullave, publikimeve statutore ashtu siç kërkohet në ligjin në fuqi, duke përfshirë pa kufizime si publikimet informative të aeroportit, njoftimet e stafit dhe të tjera të ngjashme me to.

Bazuar në Kontratën e Koncensionit, Shoqëria ka detyrim kontraktual t'i paguajë Qeverisë së Shqipërisë 30% të Fitimit të Shpërndashëm referuar si "Kuota Junior", përveç rasteve kur pagesa e një shume të tillë është e kufizuar nga Dokumentat e Financimit me Huadhënësit Kryesorë ose Huadhënësit e Nënrenditur (referencë Neni 20c dhe Shtojca 43 e Kontratës së Koncensionit).

Të drejtat e Shoqërisë
Shoqëria duhet të ketë të drejtë, përveç të drejtave të garantuara në Kontratën e Koncensionit:
(i) të punësojë apo angazhojë Persona që Shoqëria i cilëson si të domosdoshëm për të dhënë konsulencë;
(ii) të përcaktojë politikën e saj të punësimit në përputhje me ligjin në fuqi;
(iii) të ndërmarrë veprime të tjera të konsideruara si të domosdoshme prej saj për të realizuar me sukses Projektin, përmbushur detyrimet e saj dhe të ushtrojë të drejtat e saj që rrjedhin nga Kontrata;
(iv) të zgjasë afatin aq sa do të zgjasë edhe vonesa në shpronësimin e pronës private të paluajtshme në Zonën e Koncensionit dhe Shpronësimi i Kërkuar i Tokës dhe shkarkohet nga pagesat e sanksioneve;
(v) të ruajë, ashtu siç parashikohet në Kontratë, të sigurojë të mirat dhe shërbimet nga çdo burim nëpërmjet negociatave direkte në bazë të kontratave të parashikuara në ligjet në fuqi;

1. SHOQËRIA OPERUESE (VAZHDIM)

1.2 Kontrata e Koncesionit (vazhdim)

Të drejtat e Shoqërisë (vazhdim)

(vi) të optimizojë stukturën e financimit të Shoqërisë gjatë Afatit të Koncensionit;
(vii) të ndryshojë, nëse e gjykon të përshtatshme, strukturën e Aksionarëve;
(viii) t'i zgjatet afati për aq kohë sa do të zgjasë edhe çdo afat vonesa e shkaktuar nga zbulime arkeologjike dhe / ose hetime të kërkuara nga Qeveria e Shqipërisë ose Ent Shtetëror në Zonën e Koncensionit, që mund të cënojë përmbushjen nga Shoqëria të secilit prej Detyrimeve Bazë dhe Detyrimeve Shtesë, përfshi edhe shkarkimin nga përgjegjësia për pagesat e sanksioneve (për mospërmbushje të detyrimeve bazë ose detyrimeve shtesë) të shkaktuara nga zbulime dhe kërkime të tilla;
(ix) shtyrjen e një Date të Kryerjes së një detyrimi të parashikuar në Detyrimet Bazë apo Shtesë, e cila vjen si pasojë e një Ndryshimi të mundshëm; dhe
(x) të bëjë një ofertë publike fillestare të pjesëve të zakonshme të kapitalit deri në një maksimum prej 49% në çdo kohë gjatë Afatit të Koncensionit dhe në përputhje me Ligjet në fuqi me disa kushte siç është përcaktuar në Kontratë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

2.1. Baza e përputhshmërisë

Këto pasqyra finanicare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të instrumentave financiare që janë matur me vlerën e drejtë, siç përcaktohet në shënimin 2.21.

Politikat kryesore kontabël paraqiten më poshtë.

2.3. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Euro, që është monedha primare në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria operon (monedha funksionale e saj). Për qëllim të raportimit vendas, këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, që është monedha raportuese për qëllime të raportimit vendas.

Rezultati dhe pozicioni financiar i Shoqërisë konvertohen në monedhën raportuese duke konvertuar (i) aktivet dhe detyrimet me kursin e datës së raportimit; dhe (ii) të ardhurat dhe shpenzimet me kursin në datën e transaksionit (iii) kapitali aksionar me kursin historik. Të gjitha diferencat që rezultojnë nga këmbimi në monedhën raportuese njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

2.4. Transaksionet në monedha të huaja

Diferencat që rezultojnë nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kurs të ndryshëm nga ato që janë konvertuar në njohjen fillestare gjatë periudhës ose në pasqyra të mëparshme financiare, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, në periudhën që ato krijohen.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.4. Transaksionet në monedha të huaja (vazhdim)

Kurset e mëposhtme janë aplikuar gjatë vitit:

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2013	**2012**	**2013**	**2012**
Lek / USD	105.67	108.19	101.86	105.85
Lek / Euro	140.24	139.04	140.20	139.59

2.5. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë, përfshijnë llogari të arkëtueshme, para dhe ekuivalente me të, llogari të pagueshme dhe kredi bankare dhe hua të tjera. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letra me vlerë të kapitalit apo instrumenta borxhi në vazhdimësi të aktivitetit. Instrumentat financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejtë me përvetësimin e tyre. Njohja e mëtejshme e instrumentave financiarë jo-derivativë përshkruhet në vijim.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, dhe depozita bankare afatshkurtra. Në pasqyrën e rrjedhës së parasë overdraftet bankare pa afat (nëse ka), të cilat përbëjnë një pjesë përbërëse të administrimit të likuditetit nga Shoqëria, janë përfshirë në mjetet monetare dhe ekuvalentët me to. Kontabiliteti për të ardhurat dhe shpenzimet financiare shpjegohet në shënimin 2.17.

Të tjera
Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga rënia në vlerë.

Kapitali themeltar
Kapitali themeltar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

2.6. Aktivet e trupëzuara

(i) Njohja dhe matja
Aktivet e trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka.

Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur. Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj. Kur pjesë të një elementi të aktiveve të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të trupëzuara.

Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivi të trupëzuar përcaktohen duke krahasuar të hyrat nga shitja e aktivit me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto tek "të ardhura të tjera" në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (në fitim ose humbje).

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Aktivet e trupëzuara (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese
Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuara çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi
Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje) dhe llogaritet me metodën lineare sipas jetëgjatësisë së çdo pjese apo njësie të aktiveve të trupëzuara. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen sipas më të voglës midis jetëgjatësisë së aktivit dhe kohës së huasë, përveçse kur që është e qartë se Shoqëria do të fitojë pronësinë në përfundim të kontratës së qirasë. Toka nuk zhvlerësohet.
Normat e zhvlerësimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

	Në %
• Përmirësimet e ndërtesave ekzistuese	5
• Makineri dhe pajisje	20
• Pajisje kompjuterike, mobilje dhe orendi	25
• Automjete	20

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara rishikohen në çdo datë raportimi.

2.7. Aktivet e patrupëzuara

(i) Marrëveshja e shërbimit koncesionar
Shoqëria njeh një aktiv të patrupëzuar që rrjedh nga kontrata e shërbimit të koncensionit kur ka të drejtë të faturojë përdoruesit e infrastrukturës koncensionare. Aktivet e patrupëzuara njihen fillimisht me kosto, që është vlera e drejtë e pagesës për shërbimet e ndërtimit në kontratën e koncensionit.
Pas njohjes fillestare, aktivi i patrupëzuar matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë.

Shoqëria ka aplikuar standardin KIRFN 12 *Marrëveshje të shërbimit koncensionar*, efektiv për periudhën më ose pas 1 janar 2008. Meqenëse interpretimi e lejon aplikimin para hyrjes në fuqi, ai është aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të 31 dhjetorit 2007. Në bazë të KIRFN 12 *Marrëveshje të shërbimit koncensionar*, aktivet e patrupëzuara përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të përfituar shërbime koncensionare kundrejt pagesave me ose pa para në dorë dhe transferuar Qeverisë së Shqipërisë.

Në bazë të Kontratës së Koncensionit midis Shoqërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, aktivet e patrupëzuara përfshijnë tre komponentët në vazhdim të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to dhe të drejtave jo monetare të dhëna në këmbim të shërbimit koncensionar të përfituar.

1) <u>Pagesa në mjete monetare: Komision i marrjes së koncensionit (Kontrata e Koncensionit, seksioni 3 “Kushtet Paraprake”)</u>

Komisioni i marrjes së koncensionit përfaqëson komisionin e paguar nga Shoqëria ndaj Qeverisë së Shqipërisë, kundrejt përfitimit të shërbimeve koncensionare. Ky element i aktiveve të patrupëzuara regjistrohet me kosto, që është vlera e shumës së paguar.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Aktivet e patrupëzuara (vazhdim)

(i) Marrëveshja e shërbimit koncesionar (vazhdim)

2) Ekuivalentë me mjete monetare: Huaja e Qeverisë (Kontrata e Koncensionit, Seksioni 4)

Në rastin kur e drejta për të përfituar shërbime koncensionare është përfituar në këmbim të ripagimit të shumës së huasë së mëparshme, e cila përfaqëson një detyrim afatgjatë të Qeverisë, shlyerja e detyrimit është bërë nëpërmjet disa pagesave të shtyra në kohë. Kosto e këtij komponenti është vlera e drejtë e përfitimit prej tij, e cila është njohur si vlera aktuale e pagesave të shtyra në kohë, të skontuara me një normë interesi të caktuar. Ky interes është ajo normë, e cila skonton vlerën nominale të transaksionit kundrejt çmimit aktual ekuivalent në mjete monetare (shiko shënimin 17 (b)).

3) Konsiderime jo në mjete monetare: Punime ndërtimi (Kontrata e Koncensionit, Seksioni 19-32)

E drejta për të përfituar shërbime koncensionare në këmbim të punimeve ndërtimore në ndërtesat e ambienteve të reja të aeroportit (Skeduli 19-32 i Kontratës së Koncensionit), njihet me vlerën e kostos së ndërtimit, e cila konsiderohet të jetë vlera e tij e drejtë.

(ii) Aktive të tjera të patrupëzuara
Aktivet e tjera të patrupëzuara të blera nga Shoqëria, të cilat kanë jetëgjatësi të përcaktuar, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(iii) Shpenzimet e mëtejshme
Kostot e mëtejshme të aktiveve të patrupëzuara kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet ekonomike në të ardhmen, që i atribuohen atij aktivi specifik. Të gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

(iv) Amortizimi
Jeta ekonomike e një aktivi të patrupëzuar në një kontratë koncensioni është periudha kur ai është i vlefshëm për t'u përdorur deri në përfundim të periudhës së koncensionit.
Deri në përfundim të ndërtimeve, kostot e ndërtimit konsiderohen si paradhënie për marrjen e këtij komponenti të aktiveve të patrupëzuara, nuk amortizohen dhe paraqiten veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar në zërin "Punime në proçes".

2.8. Aktive të marra me qira

Qiratë, për të cilat Shoqëria marr përsipër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, klasifikohen si qira financiare. Në momentin e njohjes fillestare, aktivi i marrë me qira matet me vlerën më të vogël midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pas njohjes fillestare, aktivi kontabilizohet në përputhje me politikat kontabël të aplikueshme për atë aktiv.
Qiratë e tjera janë qira operative dhe aktivet e marra me qira nuk paraqiten në pozicionin financiar të Shoqërisë.

2.9. Inventarët

Inventarët mbahen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve bazohen në metodën "hyrja e parë, dalja e parë" dhe përfshin shpenzimet që ndodhin në blerjen e tyre, prodhimin ose këmbimin dhe kosto të tjera për t'i sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Në rastin e punimeve në proçes, kosto përfshin edhe një pjesë të përshtatshme të kostove operacionale bazuar në kapacitetin normal operacional.
Vlera neto e realizueshme është çmimi i parashikuar i shitjes në aktivitetin normal të biznesit duke hequr kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.10. Rënia në vlerë

(i) Aktivet financiare
Aktivet financiare vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënien në vlerë. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuara nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit kanë pasur një ndikim në rrjedhën e pritshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare që janë të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.
Aktivet financiare, të cilat janë të rëndësishme individualisht, testohen për rënie në vlerë në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditit.

Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje). Një humbje nga rënia në vlerë mund të çregjistrohet nëse ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur rënia në vlerë. Për aktivet financiare që maten me kosto të amortizuar, çregjistrimi regjistrohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje).

(ii) Aktivet jo-financiare
Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për rëniet e vlerës. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet rënia në vlerë. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen rrjedhat e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimin para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit. Për qëllime të testimit të rënies në vlerë, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të tyre i cili gjeneron rrjedha parash nga përdorimi i vazhdueshëm i tyre dhe që janë të pavarura nga rrjedhat e parasë të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve ("njësia gjeneruese e parasë").

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen ne pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse. Humbjet nga rënia në vlerë, që janë njohur në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka evidencë që humbja është ulur ose nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë çregjistrohet nëse ka patur ndryshime në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë çregjistrohet në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën e tij kontabël neto nga zhvlerësimi ose amortizimi që do të ishte përcaktuar, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga rënia në vlerë.

2.11. Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.12. Provigjonet

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme.
Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

Provigjon per detyrime koncesionare
Shoqëria ka si detyrim koncesionar mirëmbajtjen e pistës së uljes së avioneve në një gjendje specifike, përpara se t'i dorëzojë Qeverisë së Shqipërisë Terminalin e Ri të Pasagjerëve dhe të Kargos në fund të periudhës së koncensionit. Këto detyrime koncensionare janë njohur dhe matur sipas parashikimit më të mirë të shpenzimit që do të nevojitet për permbushjen e vlerës aktuale në datën e raportimit financiar të këtij detyrimi koncesionar. Parashikimi më i mirë i shpenzimit të nevojshëm për shlyerjen e këtij detyrimi koncesionar në çdo datë është në përpjestim të drejtë me Peshën Maksimale të ngritjes së Avionëve që përdorin këtë pistë. Provigjoni është aktualizuar duke përdorur një normë të caktuar interesi. Kjo është norma e interesit që skonton vlerën nominale të transaksionit në ekuivalentin e tij në para.

2.13. Të ardhurat

Të ardhurat operacionale kanë të bëjnë me të ardhurat nga veprimtaria aeroportuale dhe shërbimet jo-aeroportuale që i bëhen kompanive ajrore. Të ardhurat nga shërbimet e Kontratës së Koncensionit njihen në periudhën në të cilën shërbimet ofrohen nga Shoqëria. Kur Shoqëria ofron më shumë se një shërbim në një kontratë koncensioni, përfitimet shpërndahen sipas vlerës së drejtë të shërbimit të ofruar.

2.14. Kostot e zhvillimit të koncensionit

Kostot e zhvillimit të koncensionit i referohen shpenzimeve të bëra nga aksionarët dhe nga të gjitha palët e treta në lidhje me përgatitjen, dorëzimin dhe finalizimin e projektit (shpenzimet e nisjes) po ashtu kostot dhe shpenzimet në lidhje me organizime të ardhshme të Shoqërisë përpara fillimit të projektit. Këto kosto njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

2.15. Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operacionale njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose të ardhurave të tjera përmbledhëse në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Uljet e marra për qiranë njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Minimumi i pagesave të qirasë të bëra nën qiranë financiare shpërndahen midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar shpërndahet në çdo periudhë të kushteve të qirasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

2.16. Shpenzimi për tarifën e koncesionit

Shpenzimi për tarifën e koncensionit paraqet një shumë të barabartë me 30% të Fitimit të Shpërndashëm të Shoqërisë, të akumuluar dhe të regjistruar si të pagueshëm për Qeverinë e Shqipërisë, siç është përcaktuar në kontratën e koncensionit me Qeverinë e Shqipërisë. Shpenzimi për tarifën e koncesionit njihet si shpenzim në vitin kur ndodh.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.17. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare, dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen, kur ato ndodhin, në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje) dhe përllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, skonto të pazbritshme mbi provigjonet, humbjet nga kursi i këmbimit, dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

2.18. Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes, që janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që marrin kohë që të jenë gati për t'u përdorur, duke filluar nga 1 janar 2009 i janë shtuar kostos së këtyre aktiveve, deri në periudhën që aktivet janë gati për përdorim apo shitje.

Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (fitim ose humbje) në periudhën në të cilën ndodhin.

2.19. Tatim fitimi

Shpenzimi i tatim fitimit përfaqëson shumën e detyrimit tatimor dhe tatimit të shtyrë.

Tatim fitimi i vitit
Tatimi aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes me përjashtim të shumës që lidhet me zërat e njohur direkt në kapitalin aksionar, rast në të cilin ajo njihet në kapitalin aksionar.
Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm te vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë
Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të tatimit të shtyrë rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të arrihet një fitim i tatueshëm i mjaftueshëm që të lejojë që një pjesë ose i gjithë aktivi të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivet e tatimit të shtyrë maten me normën e tatimit që pritet të përdoret në periudhën në të cilën detyrimi ka ndodhur ose aktivi është realizuar, bazuar në normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.19. Tatim fitimi (vazhdim)

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit
Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

2.20. Netimi

Shoqëria nuk neton aktivet dhe detyrimet apo të ardhurat dhe shpenzimet, vetëm përveçse kur kjo kërkohet ose lejohet nga ndonjë SNRF. Gjithashtu, Shoqëria paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup i ngjashëm transaksionesh si psh: fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit. Gjithsesi Shoqëria i paraqet veçmas fitimet dhe humbjet e tilla, nëse vlerat janë materiale.

2.21. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe shënimeve shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe / ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Aty ku është e aplikueshme është prezantuar informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë në shënimet shpjeguese të aktiveve dhe detyrimeve specifike.

Aktive të trupëzuara
Vlera e tregut të pronës është shuma e vlerësuar me të cilën mund të shkëmbehet në datën e vlerësimit midis palëve në kushte të lira tregu, ku palët kanë vepruar në mënyrë të vetëdijshme, të kujdesshme dhe pa kundërshtim. Vlera e drejtë e aktiveve të trupëzuara bazohet në çmimet e tregut për njësi të ngjashme.

Aktivet e patrupëzuara
Aktivet e patrupëzuara të marra për qëllime të shërbimit në një marrëveshje koncensioni maten me vlerën e drejtë në njohjen fillestare, e cila vlerësohet duke iu referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ndërtimit që përfitohen.
Vlera e drejtë e aktiveve të patrupëzuara bazohet në skontimin e rrjedhave të pritshme nga përdorimi ose shitja e mundshme e aktivit.

Llogari të arkëtueshme
Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përjashtuar punimet në proçes, është matur si vlera aktuale e rrjedhave të ardhshme, skontuar me normën e interesit e tregut në datën e raportimit.

Detyrimet financiare jo-derivative
Vlera e drejtë që vlerësohet për qëllim paraqitjeje llogaritet duke u bazuar në vlerën aktuale të principalit të ardhshëm dhe rrjedhave të interesit të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.
Për qiratë financiare norma e interesit të tregut përcaktohet duke iu referuar marrëveshjeve të ngjashme.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse ato ndikohen.

Informacioni për elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në paragrafin e mëposhtëm ashtu si edhe në shënimet shpjeguese të mëposhtme:

(i) shënimi 7 – Vlera e drejtë e ndërtimit të Terminalit të ri të pasagjerëve
(ii) shënimi 9 – Llogari të arkëtueshme, neto
(iii) shënimi 15 – Provigjon për detyrimet koncesionare
(iv) shënimi 23 – Tatim fitimi

4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TË REJA DHE TË RISHIKUARA

4.1. Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese

Standardet e reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet në vijim, të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, janë efektive për periudhën aktuale. Me përjashtim të standardit të ri SNRF 13 "Matja e vlerës së drejtë" dhe Ndryshimeve në SNK 1 "Prezantimi i të ardhurave të tjera përmbledhëse", zbatimi i të gjitha standardeve të tjera të reja dhe ndryshimeve në standardet dhe interpretimet aktuale, nuk ka sjellë ndryshime në politikat kontabël te Shoqërisë dhe nuk kanë efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

- **SNRF 11 "Marrëveshjet e Përbashkëta**" (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

- **SNRF 12 "Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Përfshirje në Entitete të Tjera**" (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

- **SNK 27 (rishikuar në 2011) "Pasqyrat Financiare Individuale"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 janar 2013),

- **SNK 28 (rishikuar në 2011) "Investime në Filiale dhe Shoqëri të Përbashkëta**" (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

- **Ndryshime të SNRF 7 " Instrumenta Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese"-** Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare (efektive për periudhën vjetore që fillon më ose pas datës 1 janar 2013),

4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TË REJA DHE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1. Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara", SNRF 11 "Marrëveshjet e Përbashkëta" dhe SNRF 12 "Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Përfshirje me Entitete të Tjera"** Udhëzime për kalimin (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve" – Përmirësime të Kontabilizimit për Përfitimet pas Punësimit të Punonjësve** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë me apo pas datës 1 janar 2013),

- **Ndryshime të standardeve "Përmirësime të SNRF-ve (cikli 2009-2011)"** të cilat rezultojnë nga përmirësimet vjetore të SNRF (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) me synim kryesor për të shmangur mospërputhjet si dhe për të shpjeguar fjalë e terma (ndryshimet do të aplikohen për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013),

- **KIRFN 20 "Shpenzimet e Nxjerrjes në Fazën e Prodhimit të një Sipërfaqje Miniere"** – (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

SNRF 13 Matja e Vlerës së Drejtë

Shoqëria ka aplikuar SNRF 13 për herë të parë gjatë vitit aktual. SNRF 13 paraqet një burim të vetëm udhëzues për matjen e vlerës së drejtë dhe dhënies së informacioneve shpjeguese përkatëse lidhur me të. Fusha e veprimit të SNRF 13 është tepër e gjerë; kërkesat për matjet e vlerës së drejtëë SNRF 13 kanë si objektet si instrumentat financiare ashtu edhe instrumentat jo financiare për të cilat SNRF të tjera kërkojnë ose lejojnë matjen ose dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me matjen e vlerës së drejtë, përveç transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të cilat përfshihen nën SNRF 2. Pagesat e bazuara në aksione, transaksionet e qirave financiare të cilat janë pjesë e SNK 17 Qiratë Financiare dhe matjet të cilat kanë ngjashmëri me vlerën e drejtë por që nuk janë të tilla (për shembull: vlera neto e arritur për qëllime matjes së inventarit si dhe vlera e përdorur për qëllime të vlerësimit të dëmtimeve).

SNRF 13 e përkufizon vlerën e drejtë si çmimi që do të merrej nga shitja e një aseti ose çmimi që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion normal në tregun kryesor (ose më të favorshëm), në një datë të dhënë dhe nën kushtet aktuale të tregut. Vlera e drejtë sipas SNRF 13 është një çmim dalës pavarësisht nëse ky çmim është paraqitur në mënyrë direkte apo është përllogaritur duke përdorur teknika të tjera vlerësimi. SNRF 13, gjithashtu përfshin kërkesa të zgjeruara për shënimet shpjeguese që duhen paraqitur.

SNRF 13 kërkon një zbatim të mundshëm duke filluar nga 1 janar 2013. Për më tepër, Shoqërive iu janë dhënë provizione specifike të përkohshme, në mënyrë që të mos jetë i nevojshëm zbatimi i kërkesave të vendosura në Standard, në informacionin e paraqitur për periudhat para zbatimit fillestar të Standardit. Në përputhje me këto provizione të përkohshme, Shoqëria nuk ka bërë asnjë paraqitje (shënim shpjegues) të ri të kërkuar nga SNRF 13 për periudhën krahasuese 2012 (ju lutem, referojuni shënimeve 5 dhe 26 në shënimet shpjeguese të vitit 2013). Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese të paraqitura, zbatimi i SNRF 13 nuk ka patur asnjë ndikim material në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TË REJA DHE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1. Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Zërave e të Ardhurave të Tjera Përmbledhëse.

Shoqëria ka aplikuar ndryshimet e SNK 1 mbi Paraqitjen e zërave të të ardhurave përmbledhëse të tjera për herë të parë gjatë këtij viti ushtrimor. Këto ndryshime kanë prezantuar terminologji të re, përdorimi i të cilave nuk është i detyrueshëm, për pasqyrën eë ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e të ardhurave. Bazuar në ndryshimet e SNK 1, emërtimi "pasqyra e të ardhurave përmbledhëse" është ndryshuar në "pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse" dhe "pasqyra e të ardhurave" është ndryshuar në "pasqyra e fitimit ose humbjes".

Gjithsesi, ndryshimet e SNK 1 kërkojnë që zërat e të ardhurave të tjera përmbledhëse të paraqiten në dy kategori të ndryshme në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhëse:
(a) zëra që nuk do të riklasifikohen si fitim ose humbje dhe
(b) zëra që mund të riklasifikohen si fitim ose humbje kur plotësohen kushte të caktuara.

Tatimi mbi fitimin për të ardhurat e tjera përmbledhëse kërkohet të alokohet nën të njëjtat baza si më parë – ndryshimet e bëra nuk ndryshojnë mundesinë e prezantimit të zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse përpara tatimit mbi fitimin ose pas tatimit mbi fitimin në vlera neto. Këto ndryshime jane aplikuar në retrospektivë, dhe prezantimi i zërave në të ardhurat e tjera përmbledhëse nuk ka pësuar ndryshime, duke qenë se nuk ka patur ndryshime të rëndësishme për t'u reflektuar në pasqyrat financiare.

Aplikimi i ndryshimeve të ndodhura për SNK 1 nuk ka ndikime në fitim ose humbje, të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe në totalin e të ardhurave përmbledhëse.

4.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme janë publikuar por nuk janë akoma në fuqi.

- **SNRF 9 "Instrumentat Financiare" dhe ndryshimet pasuese (**efektive për periudhën vjetore më ose pas 1 janar 2018),
-
- **SNRF 14 "Llogaritë e Shtyra Rregullatore" (**efektive për periudhën vjetore më ose pas 1 janar 2016),

- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për përfshirje me Entitete të Tjera" dhe SNK 27 "Pasqyrat Financiare Individuale"** Shoqëri Investuese **(**efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2014**),**

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e Punonjesve" –** Planet e përcaktuara të përfitimit: Kontributet e punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2014),

- **Ndryshime në SNK 32 "Instrumentat Financiare: paraqitja"–** Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

4. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TË REJA DHE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

- **Ndryshime në SNK 36 "Rënia në vlerë e aktiveve"** – Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

- **Ndryshime në SNK 39 "Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja"** – Novacioni i derivativeve dhe vazhdimësia e kontabilitetit mbrojtës (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

- **Ndryshimet në disa standarde "Përmirësimet në SNRF (cikli 2010-2012**)" të cilat rezultojnë nga projektet e përmirësuara vjetore të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014),

- **Ndryshimet në disa standarde "Përmirësimet në SNRF (cikli 2011-2013)"** të cilat rezultojnë nga projektet e përmirësuara vjetore të SNRF (IFRS 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014),

- **KIRFN 21 "Taksat"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

Shoqëria ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon se aplikimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e saj financiare në periudhën e aplikimit fillestar.

5. DREJTIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit, dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proçeset e Shoqërisë për matjen dhe manaxhimin e rrezikut dhe manaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Këshilli Administrativ i Shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut. Këshilli Administrativ ka krijuar Departamentin e Kontrollit dhe Planifikimit të Biznesit, i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të manaxhimit të rrezikut. Departamenti raporton rregullisht tek Këshilli Administrativ për aktivitetet e tij.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe proçedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Këshilli Administrativ i Shoqërisë (duke vepruar në emër të Komitetit të Kontrollit) vrojton se si Drejtimi monitoron përputhjen me politikat e proçedurat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë dhe rishikon përshtatjen e strukturës së manaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet që përballet Shoqëria. Këshilli Administrativ i Shoqërisë ndihmohet nga Kontrolli i Brendshëm. Ky kryen rregullisht rishikime ad-hoc të proçedurave dhe kontrolleve të drejtimin të rrezikut, rezultatet e të cilave raportohen tek Këshilli Administrativ.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Për shkak të volumit të madh dhe të llojshmërisë së klientëve të Shoqërisë përqendrimi i rrezikut, për sa i përket kërkesave për arkëtim, është i limituar. Provigjoni për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta është caktuar në një shumë të konsiderueshme të nevojave për të mbuluar rrezikun potencial të kredisë, në mbledhjen e gjendjeve të llogarive të arkëtueshme (shënimi 24).

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjëndje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm. Për ta reduktuar më tepër ketë rrezik, Shoqëria ka marrë një kredi tjetër nga financuesit e saj kryesorë (shënimi 24).

5. DREJTIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Luhatshmëria në tregjet financiare globale dhe në Shqipëri

Kriza globale ekonomike aktuale, përveç të tjerave, ka shkaktuar nje nivel të ulët të financimit të tregjeve kapitale, nivele më të ulëta të likuiditetit përsa i përket sektorit bankar, në disa raste norma të larta të huadhënies ndërbankare dhe luhatshmëri në tregjet e aksioneve. Pasiguria në tregjet ndërkombëtare ka çuar në dështime dhe falimentime bankare në tregjet botërore. Ndikimi që do të ketë kriza globale është provuar se është i pamundur të parandalohet apo të shtyhet duke marrë masa mbrojtëse kundër saj.

Ndikimi në likuiditet

Volumi i financimit të shitjeve është zvogëluar së fundmi në mënyrë të ndjeshme. Këto rrethana mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të marrë hua të reja, nëse do të lindi nevoja, të rifinancojë huatë ekzistuese me kushte të ngjashme me ato të transaksioneve të mëparshme.

Ndikimi në klientë dhe huadhënie

Debitorët e Shoqërisë mund të preken nga mungesa e likuiditetit, e cila mund të ndikojë në aftësinë paguese të borxheve që ata kanë ndaj Shoqërisë. Përkeqësimi i kushteve operative mund të ndikojë edhe në parashikimin e rrjedhave financiare nga ana e Drejtimit dhe përcaktimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Me supozimin që një informacion i tillë është i disponueshëm, Drejtimi ka rivlerësuar në mënyrën e duhur rrjedhjet e ardhshme të pritshme dhe vlerësimin e provigjoneve.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria përballet me rrezikun e normës së interesit lidhur me huatë kryesore dhe të Infrastrukturës. Huaja kryesore e marrë nga Alpha Bank, Tirana Branch dhe Intesa Sanpaolo Bank dhe huaja e Infrastrukturës janë me një normë të ndryshueshme interesi, ndërsa huatë kryesore të marra nga EBRD dhe DEG janë me norma të fiksuara deri në maturim.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në Euro nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e mbron Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

Analiza e ndjeshmërisë

Me anën e manaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2013 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e normave të interesit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

5. DREJTIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Manaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Drejtimi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit, duke përjashtuar aksionet e preferuara të parevokueshme dhe interesat e pakicës. Drejtimi gjithashtu monitoron nivelin e dividendëve ndaj aksionarëve të zakonshëm.

Shoqëria kërkon që të mbajë një balancë midis kthimeve më të larta të cilat janë të mundshme nga nivele të larta borxhi dhe me avantazhet dhe sigurinë që të jep pozicioni me kapital të fuqishëm.

Gjatë këtij viti nuk ka patur ndryshime në mënyrën e manaxhimit të kapitalit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

6. AKTIVE TË TRUPËZUARA, NETO

	Përmirësimet e ndërtesave ekzistuese	Toka	Makineri dhe pajisje	Kompjutera dhe pajisje zyre	Automjete	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2012	**37,515,685**	**5,026,348**	**301,931,429**	**434,784,769**	**289,938,436**	**1,069,196,667**
Shtesa	-	-	3,722,115	44,957,642	7,778,461	**56,458,218**
Pakësime	-	-	(225,000)	(5,739,418)	(12,524,445)	**(18,488,863)**
Diferenca konvertimi	178,221	23,879	1,482,685	1,439,152	(287,446)	**2,836,491**
Më 31 dhjetor 2012	**37,693,906**	**5,050,227**	**306,911,229**	**475,442,145**	**284,905,006**	**1,110,002,513**
Shtesa	**-**	**-**	1,501,341	30,167,702	**-**	**31,669,043**
Pakësime	**-**	**-**	(205,000)	(28,400,436)	(22,263,805)	**(50,869,241)**
Diferenca konvertimi	164,721	22,069	1,336,225	(1,343,973)	(1,008,373)	**(829,331)**
Më 31 dhjetor 2013	**37,858,627**	**5,072,296**	**309,543,795**	**475,865,438**	**261,632,828**	**1,089,972,984**
Zhvlerësim i akumuluar						
Më 1 janar 2012	**(9,430,429)**	**-**	**(191,893,152)**	**(306,383,162)**	**(227,036,905)**	**(734,743,648)**
Zhvlerësimi për vitin	(1,901,672)	-	(40,317,640)	(55,870,669)	(24,560,705)	**(122,650,686)**
Pakësime	-	-	51,712	5,634,241	12,524,446	**18,210,399**
Diferenca konvertimi	(267,409)	-	(2,792,905)	(2,620,395)	(1,270,804)	**(6,951,513)**
Më 31 dhjetor 2012	**(11,599,510)**	**-**	**(234,951,985)**	**(359,239,985)**	**(240,343,968)**	**(846,135,448)**
Zhvlerësimi për vitin	(1,896,476)	-	(31,369,469)	(52,750,448)	(23,414,622)	**(109,431,015)**
Pakësime	-	-	60,353	27,966,055	20,823,455	**48,849,863**
Diferenca konvertimi	(281,889)	-	(1,810,272)	1,091,980	(551,747)	**(1,551,928)**
Më 31 dhjetor 2013	**(13,777,875)**	**-**	**(268,071,373)**	**(382,932,398)**	**(243,486,882)**	**(908,268,528)**
Vlera neto						
Më 31 dhjetor 2012	**26,094,396**	**5,050,227**	**71,959,244**	**116,202,160**	**44,561,038**	**263,867,065**
Më 31 dhjetor 2013	**24,080,752**	**5,072,296**	**41,472,422**	**92,933,040**	**18,145,946**	**181,704,456**

6. AKTIVE TË TRUPËZUARA, NETO (VAZHDIM)

Automjetet më 31 dhjetor 2013 përfshijnë shumat e mëposhtme, ku Shoqëria është marrëse me qira sipas kontratave të qirasë financiare:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Kosto – qira financiare të kapitalizuara	100,600,984	107,121,914
Zhvlerësim i akumuluar	(100,600,984)	(107,121,914)
	-	-

Të gjitha aktivet e trupëzuara të Shoqërisë janë të vendosura si garanci në "Marrëveshjen për Sigurimin e Detyrimeve mbi inventarët dhe sigurimin e aktiveve të luajtshme" të hyrë në fuqi më 8 prill 2005 dhe ndryshuar më 28 mars 2008, e cila parashikon rikthimin e aktiveve dhe inventarëve tek kreditorët në rastin e mosplotësimit të detyrimeve (shiko gjithashtu edhe shënimin 12 më poshtë, tek Huatë Kryesore).

7. AKTIVE TË PATRUPËZUARA, NETO DHE PUNIME NË PROÇES

	Pagesa koncesionare	Kredia e mëparshme	Terminali i ri i pasagjerëve dhe kargos dhe terminali ekzistues	Aktive të tjera të patrupëzuara	Punime në proçes	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2012	416,790,000	931,921,462	9,260,175,201	84,416,925	38,137,674	**10,731,441,262**
Shtesa	-	-	7,997,294	-	60,711,654	**68,708,948**
Transferime	-	-	50,076,000	-	(50,076,000)	**-**
Diferenca konvertimi	1,980,000	4,427,180	43,762,737	401,030	673,516	**51,244,463**
Më 31 dhjetor 2012	**418,770,000**	**936,348,642**	**9,362,011,232**	**84,817,955**	**49,446,844**	**10,851,394,673**
Shtesa	-	-	14,700,644	8,685	40,730,350	**55,439,679**
Transferime	-	-	60,780,760	-	(60,780,760)	**-**
Diferenca konvertimi	1,830,000	4,091,788	41,265,316	370,657	(327,352)	**47,230,409**
Më 31 dhjetor 2013	**420,600,000**	**940,440,430**	**9,478,757,952**	**85,197,297**	**29,069,082**	**10,954,064,761**
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 janar 2012	(138,930,000)	(310,640,255)	(2,004,213,149)	(10,103,684)	-	**(2,463,887,088)**
Amortizimi për vitin	(18,873,000)	(41,561,832)	(457,579,363)	(32,764,409)	-	**(550,778,604)**
Diferenca konvertimi	(2,725,500)	(6,731,264)	(64,243,016)	222,789	-	**(73,476,991)**
Më 31 dhjetor 2012	**(160,528,500)**	**(358,933,351)**	**(2,526,035,528)**	**(42,645,304)**	**-**	**(3,088,142,683)**
Amortizimi për vitin	(18,873,000)	(41,561,832)	(462,639,973)	(32,677,783)	-	**(555,752,588)**
Diferenca konvertimi	(2,858,500)	(7,028,643)	(67,870,124)	(57,861)	-	**(77,815,128)**
Më 31 dhjetor 2013	**(182,260,000)**	**(407,523,826)**	**(3,056,545,625)**	**(75,380,948)**	**-**	**(3,721,710,399)**
Vlera neto						
Më 31 dhjetor 2012	**258,241,500**	**577,415,291**	**6,835,975,704**	**42,172,651**	**49,446,844**	**7,763,251,990**
Më 31 dhjetor 2013	**238,340,000**	**532,916,604**	**6,422,212,327**	**9,816,349**	**29,069,082**	**7,232,354,362**

7. AKTIVE TË PATRUPËZUARA, NETO DHE PUNIME NË PROÇES (VAZHDIM)

Aktive të tjera të patrupëzuara përfshijnë një vlerë prej 73,376,879 Lek (ekuivalente në 525,660 Euro), e cila është vlera e blerjes për marrjen përsipër të biznesit të shitjes me pakicë, ushqim dhe pije nga Hochtief AirPort Retail Sh.p.k. ("HTAR"). Proçesi i marrjes përsipër të kësaj pjese të biznesit u finalizua më 1 tetor 2011 dhe amortizimi është llogaritur duke përdorur metodën lineare deri në datën e përfundimit të kontratës origjinale me HTAR. Shtesat e vitit 2013 në shumën 8,685 Lek (equivalente të 62 Euro) perfaqësojnë cmimin e blerjes për marrjen përsipër të bisnesit të Duty Free e cila më parë manaxhohej nga HTAR. Marrja përsipër u finalizua në datën 1 nëntor 2013 dhe amortizimi është llogaritur duke përdorur metodën lineare deri në datën e përfundimit të kontratës origjinale me HTAR, e cila në datën e blejrjes ndryshoi emrin në AviAlliance Retail GmbH.

8. PARAPAGIM I TATIMIT MBI FITIMIN

Parapagimi i tatimit mbi fitimin në shumën 145,689 mijë Lek (2012: 149,671 mijë Lek) është rezultat i pagesave të bëra nga Shoqëria gjatë vitit 2013 në shumën 220,030 mijë Lek (2012: 89,545 mijë Lek) dhe kompensimit kundrejt TVSH-së së mbledhshme në shumën 20,681 mijë Lek (2012: 158,629 mijë Lek) minus tatimin mbi fitimin e vitit 2013 në shumën 244,693 mijë Lek (2012: 220,030 mijë Lek) (shiko gjithashtu shënimin 23) dhe diferencat e konvertimit, që vijnë si rezultat i përkthimit të balancës së mbetur në 31 dhjetor 2013 nga monedha funksionale Euro në monedhën raportuese Lek.

9. LLOGARI TË ARKËTUESHME, NETO

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Llogari të arkëtueshme nga kompanitë ajrore	2,996,573,875	2,947,042,319
Llogari të tjera të arkëtueshme	55,955,027	66,694,097
	3,052,528,902	**3,013,736,416**
Minus: Provigjion për llogari të dyshimta	(1,324,013,520)	(546,735,249)
Llogari të arkëtueshme, neto	**1,728,515,382**	**2,467,001,167**

Lëvizja e provigjonit për llogaritë e dyshimta paraqitet si më poshtë:

	2013	**2012**
Më 1 janar	546,735,249	448,669,367
Rritja në provigjon për vitin	778,842,304	98,226,529
Provigjionet e arkëtuara	(3,959,552)	(2,266,397)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	2,395,519	2,105,750
Më 31 dhjetor	**1,324,013,520**	**546,735,249**

Më 31 dhjetor 2013, Shoqëria ka njohur një shumë prej 778,842 mijë Lek (2012: 98,227 mijë Lek) si provigjon për llogaritë e dyshimta për disa kompani ajrore dhe klientë komercialë, të cilët aktualisht po përballen me vështirësi financiare. Kompanitë kryesore ajrore të përfshira në shumën e mësipërme janë Belle Air dhe Belle Air Europe të cilat ndaluan veprimtarinë në fund të nëntorit të vitit 2013. Manaxhimi i Shoqërisë beson se mundësia e arkëtimit të balancës së mbetur nga këto dy kompani është shumë e ulët dhe ka vendosur të provigjonojë shumën e plotë të mbetur nga të dyja kompanitë në vitin 2013. Gjithashtu, gjatë vitit 2013 Shoqëria ka arkëtuar një shumë prej 3,959,552 Lek nga disa klientë (2012: 2,266,397 Lek), të cilët më parë kanë qenë të provigjonuar.

Gjendja e mbartur e llogarive të arkëtueshme përfshin shumën prej 1,531,768 mijë Lek (2012: 1,307,734 mijë Lek), e cila lidhet me tarifën e kalimit të kufirit (referuar ne Kontratën e Koncesionit si “taksa e kalimit të kufirit”) (shiko shënimin 17) për të cilën Shoqëria ka detyrim t’ia transferojë zyrës së tatimeve pasi ta arkëtojë nga kompanitë ajrore.

10. AKTIVE TË TJERA

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
TVSH e arkëtueshme	107,974,765	94,106,999
Inventar	24,689,314	15,733,199
Aktive të tjera	22,597,181	5,627,017
Parapagim i taksës së vizës	5,575,450	5,551,191
Interesa të arkëtueshme nga llogari bankare	2,067,249	11,300,443
Aktive të tjera	1,357,944	294,860
Parapagim i tatimit në burim	-	6,298,422
Totali	**164,261,903**	**138,912,131**

Aktive të tjera përfshin shumën prej 13,707 mijë Lek për tu arkëtuar nga Ministria e Transpotit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për dëmtimin e tokës së Pirro Zotos (paditësi) gjatë proçesit të shpronësimit dhe ndërtimit të rrugës hyrëse. Shuma totale e vlerësuar nga Gjykata për t'iu rimbursuar paditësit është 20,561,031 Lek (ekuivalente e 146,655 Euro) ku të treja palët e paditura, duke përfshirë Shoqërinë Tirana International Airport Sh.p.k. janë përgjegjës solidarë (detyrim i përbashkët dhe individual). Duke patur parasysh që shuma është paguar e plotë nga Shoqëria, diferenca midis detyrimit total ndaj paditësit dhe pjesës së Shoqërisë është regjitruar si aktive të tjera.

11. PARA NË ARKË DHE BANKË

Para në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Para në arkë		
Në Lek	94,864	55,555
Në Euro	174,863	149,294
	269,727	**204,849**
Para në bankë		
Në Euro	1,852,593,329	1,641,446,044
Në Lek	4,652,414	12,069,697
Në USD	1,353,098	1,454,436
	1,858,598,841	**1,654,970,177**
Paraja në tranzit në Euro	4,000,000	4,000,000
Totali i parasë në arkë dhe bankë	**1,862,868,568**	**1,659,175,026**
Minus: Fonde të ngurtësuara në bankë	(588,840,000)	(628,155,000)
Totali i parasë dhe ekuivalentë të saj	**1,274,028,568**	**1,031,020,026**

11. PARA NË ARKË DHE BANKË (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraja në bankë në Euro përfshin llogari rrjedhëse tek Alpha Bank, Tirana Branch, Raiffeisen Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank për pagesën e kësteve të huave respektive si dhe pagesave të tjera të lidhura me aktivitetet ditore operacionale.

Paraja në tranzit përbëhet nga shuma të depozituara si garanci.

Më 31 dhjetor 2013, shuma prej 588,840 mijë Lek (2012: 628,155 mijë Lek) përfaqëson fonde të ngurtësuara të vendosura në Llogarinë Rezervë të Shërbimit të Borxhit tek Raiffeisen Bank dhe Llogarinë Rezervë për investime Kapitale tek Alpha Bank, Tirana Branch, siç është kërkuar në seksionin 5.16 (c) të Marrëveshjes së Ndryshuar për Kushtet e Përbashkëta. Lidhur me Llogarinë Rezervë të Shërbimit të Borxhit, Shoqëria ka përdorur një nga dispozitat e Marrëveshjes së Ndryshuar për Kushtet e Përbashkëta, sipas së cilës Llogaria Rezervë e Shërbimit të Borxhit mund të zëvendësohet në çdo moment me një letër kredi të lëshuar nga institucionet financiare të zonës së 1 cilësuar nga OECD, të cilat janë të vlerësuara nga S&P me A- (ose ekuivalente). Si rrjedhim, Shoqëria e ka përdorur këtë dispozitë dhe një letër kredi është lëshuar nga Raiffeisen Bank Viena e mbështetur me një garanci në cash të vendosur tek Raiffeisen Bank në Tiranë.

12. KREDI BANKARE DHE HUA TË TJERA

Kredi bankare dhe hua të tjera të matura me koston e amortizuar më 31 dhjetor 2013 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Pjesa afatgjatë		
Marrëveshja e Huasë Kryesore (a)	3,881,296,165	4,267,180,456
Hua për ndërtime infrastrukturore (BERZH) (b)	520,054,204	621,646,446
	4,401,350,369	**4,888,826,902**
Pjesa afatshkurtër		
Marrëveshja e Huasë Kryesore (a)	411,352,425	379,882,415
Hua për ndërtime infrastrukturore (BERZH) (b)	105,150,219	104,692,681
Interes i pagueshëm për kreditë bankare dhe huatë e tjera	48,282,283	53,227,645
	564,784,927	**537,802,741**
Totali	**4,966,135,296**	**5,426,629,643**

(a) Më datë 23 mars 2005, Shoqëria mori hua në shumën prej 3,490,980 mijë Lek (ekuivalente me 24,900,000 Euro) (Transhi 1), të cilat u disbursuan plotësisht gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012. Më tej, më datë 28 mars 2008, Shoqëria mori hua të tjera në shumën 3,084,400 mijë Lek (22,000,000 Euro) (Transhi 2), e cila përfaqësonte limitin maksimal të kësaj kredie. Disbursimi aktual është 18,007,047 Euro (Lek 2,524,588 mijë) dhe diferenca është anulluar. Transhi 2 është përdorur për financimin e punimeve për zgjerimin e Terminalit të Ri të Pasagjerëve (Faza B). Të dy huatë janë mbledhur në një si dhe rregullohen nga Marrëveshja e Kushteve të Përgjithshme të Ndryshuara dhe Rikonstatuara, nënshkruar më datë 28 mars 2008. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012, shuma e disbursuar e kredisë për Fazën B është 2,524,588 mijë Lek.

12. KREDI BANKARE DHE HUA TË TJERA (VAZHDIM)

Gjendja për çdo kredidhënës më datë 31 dhjetor 2013 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Kredi nga BERZH	2,094,264,090	2,268,209,521
Kredi nga DEG	871,158,156	943,514,100
Kredi nga Alpha Bank, Tirana Branch	852,689,297	923,510,700
Kredi nga Intesa Sanpaolo (dikur Banka Amerikane e Shqipërisë (“ABA”))	527,921,572	571,771,936
Totali	**4,346,033,115**	**4,707,006,257**

Më 31 dhjetor 2013 totali i principalit në shumën 3,490,980 mijë Lek (24,900,000 Euro) ka të bëjë me Transhin 1 dhe shuma prej 2,524,588 mijë Lek (18,007,047 Euro) me Transhin 2 të disbursura, paraqitur neto me shumën e paamortizuar të komisioneve të disbursimit paguar bankave për huatë e marra nga grupi i institucioneve financiare, siç detajohet më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Principali bruto i Huasë Kryesore	4,346,033,116	4,707,006,257
Komisioni fillestar i paamortizuar i kredisë	(53,384,526)	(59,943,386)
Gjendja sipas kostos së amortizuar	**4,292,648,590**	**4,647,062,871**

Data e maturimit të huave është ndryshuar në bazë të Marrëveshjes së Kushteve të Përgjithshme të Ndryshuara dhe Rikonstatuara dhe është shtyrë më datë 15 tetor 2021. Përqindja e interesit është ndryshuar duke filluar nga data 15 prill 2008 në 6 muaj Euribor + tarifë (fillimisht e vendosur në nivelin 3%) dhe paguhet çdo gjashtë muaj. Ndryshimi në tarifë është subjekt i arritjes së disa kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Kushteve të Përgjithshme të Ndryshuara dhe Rikonstatuara. Gjithashtu, si rezultat i vendimit të marrë në Këshillin Administrativ, interesi për kreditë e marra nga BERZH dhe DEG është fiksuar deri në maturimin e këtyre kredive me një normë prej 3.59% dhe 3.55% respektivisht, ndërsa interesi për kreditë e marra nga Alpha Bank, Tirana Branch dhe Intesa Sanpaolo Bank do të vazhdojë të jetë Euribor 6 mujor plus tarifë. Kompensimi i principalit për huatë Transhi 1 ka filluar më datë 15 prill 2008 ndërkohë principali i Transhi 2 paguhet në këste çdo gjashtë muaj duke filluar nga data 15 prill 2010 deri në datën e maturimit. Huaja është garantuar nga një garanci e mëparshme huaje bazuar në të gjitha aktivet e trupëzuara të Shoqërisë (shih shënimin 6).

(b) Më datë 23 mars 2005 sipas një marrëveshjeje huaje nënshkruar ndërmjet Shoqërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Shoqëria mori një hua kryesore në lidhje me Marrëveshjen e Koncesionit. Qëllimi i huasë është mbështetja ndaj Shoqërisë për ndërtimin e një ure të re dhe të një rruge të re për në aeroport. Shuma totale e aprovuar e huasë është 1,261,800 mijë Lek (9,000,000 Euro). Shoqëria filloi shlyerjen e principalit pas tre vitesh nga data e marrëveshjes, më datë 15 prill 2008. Principali shlyhet me këste gjashtë mujore duke filluar nga data 15 prill 2008 deri në datën e maturimit 15 tetor 2019. Përqindja e interesit, e cila i paguhet BERZH, është 6 muaj Euribor + 1% në vit. Megjithatë Shoqëria do t’i paguajë Qeverisë së Shqipërisë një tarifë garancie të huasë kryesore e llogaritur duke marrë parasysh diferencën ndërmjet përqindjes së interesit të paguar sipas marrëveshjes për huanë kryesore dhe përqindjes së interesit të paguar sipas marrëveshjeve të cilat rregullojnë borxhin fillestar të Shoqërisë (shënimi 12.a më sipër). Huaja është garantuar me anë të një garancie të dhënë nga Qeveria e Shqipërisë dhe është në Euro.

12. KREDI BANKARE DHE HUA TË TJERA (VAZHDIM)

Më datë 31 dhjetor 2013 shuma totale e principalit të disbursuar prej 1,261,800 mijë Lek (9,000 mijë Euro) është paraqitur neto me komisionin fillestar të paamortizuar të kredisë paguar bankave për huatë e marra nga BERZH, siç detajohet më poshtë:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Principali bruto i Huasë Kryesore	630,899,778	732,847,243
Komisioni fillestar i paamortizuar i kredisë	(5,695,356)	(6,508,116)
Gjëndja sipas kostos së amortizuar	**625,204,422**	**726,339,127**

13. LLOGARI TË PAGUESHME

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
ICTS	39,256,000	19,263,420
Trema Engineering Sh.p.k.	37,771,983	10,470,227
Furnitorë të tjerë	22,212,154	64,690,159
Belle Air Sh.p.k.	-	62,036,588
Totali	**99,240,137**	**156,460,394**

Furnitorë të tjerë përfaqësojnë detyrime të Shoqërisë të lidhura me aktivitetin ditor që janë të pagueshme në fillim të vitit 2014.

14. PALË TË LIDHURA

Marrëdhëniet me palët e lidhura identifikohen si më poshtë: (referoju shënimit 1):

- AviaAlliance GmbH (former Hochtief Airport GmbH (HTA)),
- Albanian American Enterprise Fund (AAEF) dhe
- Deutsche Investitions – und Entëicklungsgesellschaft mbH (DEG)
- AviAlliance Retail Sh.p.k. (dikur Hochtief AirPort Retail Sh.p.k. (HTAR))

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria ka patur një detyrim prej 10,432 Lek kundrejt AviAlliance Retail Sh.p.k (2012: zero).

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2013 janë zero (2012: 8,642,994 Lek të arkëtueshme nga AviAlliance Retail Sh.p.k).
Me 1 tetor 2011 Shoqëria mori përsipër aktivitetin e shitjes me pakicë dhe të shitjes së specializuar të ushqimit dhe pijeve nga HTAR nëpërmjet firmosjes së një Kontrate për Përfundim të Pjesshëm të Kontratës origjinale të Shitjes me Pakicë. Gjitshatu, më 1 nëntor 2013 Shoqëria mori përsipër aktivitetin e duty free nëpermjet firmosjes së një kontrate Step-In përkundrejt Kontratës origjinale të Shitjes me Pakicë.

Gjatë periudhës nga janari në tetor 2013, Shoqëria ka pasur të ardhura nga aktiviteti i duty free në shumën 28,621 mijë Lek dhe të ardhura të tjera në shumen 230 mijë Lek (2012: të ardhura aktiviteti i duty free 36,661 mije Lek dhe të ardhura të tjera 274 mijë Lek).

14. PALË TË LIDHURA (VAZHDIM)

Shpenzimet kryesore që ka bërë Shoqëria me palët e lidhura, të njohura si shpenzime dhe që janë përfshirë në "shpenzime aviacioni" ,"shpenzime udhëtimi" dhe "shpenzime ligjore" ose kapitalizuar si pjesë e punimeve në proçes për ndërtimin e terminalit të ri për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, janë detajuar si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	**Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012**
AviAlliance GmbH (ish Hochtief Airport GmbH)	79,622,139	79,256,082
Albanian American Enterprise Fund (AAEF)	154,007	-
Deutsche Investitions-und Entëicklungs gesellschaft mbH	95,153	-
Totali	**79,871,299**	**79,256,082**

Transaksionet e mësipërme janë kryer sipas termave dhe kushteve tregtare me një çmim që i përafrohet tregut.

Shoqëria ka gjithashtu marrëdhënie si palë të lidhura me manaxherët dhe me drejtorët ekzekutivë të saj.

Kompensimi për drejtorët ekzekutiv për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, përfshirë në shënimin 20, është 50,481,573 Lek (2012: 61,968,255 Lek).

15. PROVIGJION PËR DETYRIMET KONÇENSIONARE

Shoqëria ka si detyrim të mirëmbajë pistën e uljes së avionëve sipas Shtojcës Nr. 23 të Kontratës së Koncesionit. Si rezultat i rishikimit të planit të investimeve kapitale në planin afatgjatë të kryer nga Shoqëria gjatë vitit 2012, kjo e fundit ka ndryshuar afatet kohore të nevojës për kryerjen e mirëmbajtes, duke i ndarë punimet në dy faza: 4 milion Euro në vitin 2017 dhe 2 milion Euro në vitin 2020. Totali i shumës së parave të nevojshme për kryerjen e këtyre punimeve mbetet i pandryshuar në shumën prej 6 million Euro. Sipas KIRFN 12 *Marrëveshjet Koncensionare të Shërbimit*, ky detyrim kontraktual është njohur dhe matur sipas parimeve të SNK 37 *Provigjonet, Pasivet dhe Aktivet e Kushtëzuara*, me parashikimin më të mirë të shpenzimit që do të duhej për përmbushjen e detyrimit në datën e raportimit.

16. TARIFA E PAGUESHME E KONCENSIONIT

Siç është detajuar tek Shënimi 1 i pasqyrave financiare, bazuar në marrëveshjen e koncensionit, Shoqëria ka detyrim kontraktual t'i paguajë Qeverisë së Shqipërisë 30% të Fitimit të Shpërndashëm referuar si "Kuota Junior" (referencë neni 20c dhe skeduli 43 i Kontratës së Koncensionit). Mbështetur në këtë kontratë, Shoqëria nuk është e detyruar të paguajë këtë shumë nëse pagesa e një shume të tillë është e kufizuar nga Dokumentat e Financimit me Huadhënësit Kryesorë ose Huadhënësit e Nënrenditur. Në këtë rast, gjatë kësaj periudhe, Shoqëria duhet të akumulojë shumën dhe kjo vlerë e akumuluar duhet të njihet si e pagueshme ndaj Qeverisë së Shqipërisë siç parashikohet në Kontratën e Koncesionit.
Gjatë vitit të mbyllur ushtrimor më 31 dhjetor 2013, Shoqëria i pagoi Qeverisë së Shqipërisë të gjithë shumën e detyrimit të mbartur deri më 31 dhjetor 2012 prej 380,873 mijë Lek dhe shuma e detyrimit më 31 dhjetor 2013 lidhet vetëm me detyrimin për vitin aktual.

17. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Pjesa afatshkurtër		
Tarifa e kalimit të kufirit (a)	1,531,768,318	1,307,733,602
Huaja e Qeverisë – pjesa afatshkurtër (b)	82,552,305	88,925,525
Detyrime ndaj personelit (c)	35,748,108	100,898,458
Taksa e sigurisë (a)	10,054,583	9,567,150
Të tjera taksa të pagueshme	8,952,357	8,846,317
Detyrimi i Agjensisë së Trafikut Kombëtar	8,753,387	926,180
Të tjera	551,639	292,897
	1,678,380,697	**1,517,190,129**
Pjesa afatgjatë		
Huaja e Qeverisë – pjesa afatgjatë (b)	583,403,571	663,058,366
Totali	**2,261,784,268**	**2,180,248,495**

(a) Taksa e sigurisë dhe tarifa e kalimit të kufirit përfaqësojnë shuma të paguara nga çdo pasagjer që kalon nga aeroporti. Shoqëria i mbledh këto taksa nga kompanitë ajrore për llogari të autoriteteve shqiptare të taksave.

(b) Shuma e borxhit të mëparshëm paraqet një kredi të mëparshme që Kreditanstalt fur Wiederaufbau ("KfW") i ka akorduar Qeverisë së Shqipërisë, kredi e cila do të paguhet nga Shoqëria gjatë periudhës së koncensionit në përputhje me skedulin 4 të kontratës së koncensionit (shënimi 7). Detyrimi është i pagueshëm sipas skedulit të dhënë nga Qeveria e Shqipërisë, megjithatë interesi dhe principali nuk janë të identifikuar më vete për çdo këst. Si rrjedhim, vlera e drejtë e kredisë është konsideruar vlera aktuale e pagesave të shtyra, e cila është e llogaritur duke skontuar të gjitha pagesat e ardhshme duke përdorur një normë interesi 7.5%, që përfaqëson normën normale të huamarrjes afatgjatë së Shoqërisë. Data e maturimit e detyrimit është 15 dhjetor 2025 dhe principali është i pagueshëm me këste gjashtëmujore.

c) Shuma e detyrimit ndaj personelit përfaqëson pjesërisht detyrimin për pagën e dhjetorit 2013 e paguar në fillim të janarit 2014.

18. KAPITALI THEMELTAR

Bazuar në vendimin e aksionarëve të datës 25 maj 2005 dhe në përputhje me marrëveshjen e financimit të aksionarëve datë 5 shkurt 2005, kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është 1,161,148,883 Lek (9,375,000 Euro). Struktura e kapitalit më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012	
	Në %	**Shuma**
AviAlliance GmbH (më parë HOCHTIEF Airport GmbH ("HTA"))	47.0%	545,739,975
DEG-Deutsche Investitions-und Entwicklungsgesellschaft mbH ("DEG")	31.7%	368,084,196
Albanian-American Enterprise Fund ("AAEF")	21.3%	247,324,712
Totali	**100%**	**1,161,148,883**

18. KAPITALI THEMELTAR (VAZHDIM)

Gjatë vitit 2013 u pagua dividend në shumën 1,452,791 mijë Lek (ekuivalente në 10,600 mijë Euro) bazuar në vendimin e aksionarëve datë 17 prill 2013 (2012: 1,332,502 mijë Lek).

19. TË ARDHURA

Të ardhurat e njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Të ardhura nga aviacioni	4,286,741,125	4,124,176,226
Tarifa qiraje	136,412,072	135,130,945
Shitje	118,316,957	126,271,289
Reklama	54,341,277	73,191,993
Të ardhura të tjera	26,316,112	8,284,668
Totali	**4,622,127,543**	**4,467,055,121**

Tarifat e qirave paraqesin të ardhura nga dhënia me qira e dyqaneve dhe zyrave të ndryshme që ndodhen në zonën e terminalit të ri si dhe të ardhura të tjera nga aktivitetet jo aeronautike si karburanti dhe parkimi. Të gjitha kontratat e qirave janë në Euro dhe janë kontrata me afat të shkurtër.
Të ardhurat nga shitja e specializuar deri më 31 tetor 2013 dhe gjatë vitit 2012 përfaqësojnë të ardhura nga marrëveshja me AviAlliance Retail Sh.p.k. (më parë HTAR) bazuar mbi xhiron e biznesit të duty free dhe përqindjeve të përcaktuara në kontratën midis dy palëve. Më 1 nëntor 2013 Shoqëria dhe AviAlliance Retail Sh.p.k. firmosën Marrëveshjen Step-in të Kontratës origjinale të Shitjes me Pakicë. Të ardhurat nga duty free në dy muajt e fundit të vitit financiar 2013 janë rezultat i manaxhimit direkt të Shoqërisë të këtij aktiviteti.
Të ardhura të tjera përfshin mbylljen e balancës së pagueshme kundrejt SITA-s si rrjedhojë e një konfirmimi të marrë nga furnitori mbi balancën e mbetur më 31 dhjetor 2013. Kjo shumë ka të bëjë me vlera të vjetra të mbetura pa paguar si rezultat i mospërputhjes së shërbimeve të mara dhe shumave të faturuara nga furnitori.

20. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personeli si dhe shpenzimet e lidhura me to për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Paga	358,544,645	369,993,103
Sigurime shoqërore dhe tatim mbi të ardhurat	44,960,548	44,218,606
Udhëtime dhe trajnime	37,456,803	32,575,504
Punonjës me kontratë shërbimi	1,372,422	1,407,272
Shpenzime të tjera	21,004	76,744
Totali	**442,355,422**	**448,271,229**

21. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shërbime sigurimi	256,766,512	248,755,608
Shërbime mirëmbajtje	213,539,171	204,846,716
Shërbime aviacioni	135,529,928	135,494,422
Karburante dhe të tjera	133,858,874	158,136,772
Shërbime të ofruara	103,809,887	116,821,926
Siguracion	36,730,489	37,858,502
Materiale	27,751,199	26,987,737
Komisione dhe taksa të tjera	23,670,877	21,601,278
Përfaqësime dhe reklama	17,404,582	13,809,428
Qira operacionale dhe financiare	8,712,760	9,769,678
Komunikim	7,110,386	14,868,836
Shpenzime transporti	6,321,173	6,221,058
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara	2,019,378	278,464
Totali	**973,225,216**	**995,450,425**

22. SHPENZIME FINANCIARE, NETO

Shpenzimet dhe të ardhurat financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi	(322,375,584)	(330,718,366)
Provigjone për llogari të dyshimta	(774,882,752)	(95,960,132)
Humbje nga konvertimi	(90,420,744)	(53,424,944)
Komisione bankare	(6,803,490)	(6,337,803)
	(1,194,482,570)	**(486,441,245)**
Të ardhura financiare		
Të ardhura nga konvertimi	82,483,417	33,649,535
Të ardhura nga interesi	26,789,835	44,184,209
	109,273,252	**77,833,744**
Shpenzime financiare, neto	**(1,085,209,318)**	**(408,607,501)**

23. TATIMI MBI FITIMIN

23.1 Tatimi i shtyrë aktiv dhe tatimi i shtyrë pasiv

Më 31 dhjetor 2013 tatimi i shtyrë aktiv dhe tatim i shtyrë pasiv vijnë nga zërat e mëposhtëm:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Tatimi i shtyrë aktiv		
Aktive afatgjata	198,602,028	12,915,003
Kërkesa për arkëtim dhe të tjera	-	54,673,525
	198,602,028	**67,588,528**
Tatimi i shtyrë pasiv		
Aktive afatgjata	13,733,856	-
Furnitorë dhe detyrime të tjera	36,962,385	19,351,022
	50,696,241	**19,351,022**
Tatimi i shtyrë neto aktiv	**147,905,787**	**48,237,506**

Norma e aplikueshme e taksës për qëllim të llogaritjes së tatimit të shtyrë për vitin 2013 është 15% dhe për vitin 2012 është 10%. Norma e taksës ka ndryshuar me datë efektive 1 janar 2014 bazuar në një vendim të Ministrisë së Financave. Lëvizja në tatimin e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

	2013	2012
Më 1 janar	(48,237,506)	(22,383,348)
Tatimi i shtyrë	(99,668,281)	(25,854,158)
Më 31 dhjetor	**(147,905,787)**	**(48,237,506)**

23.2 Tatim fitimi

Tatim fitimi për periudhën e treguar përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Tatimi mbi fitimin	244,693,266	220,030,037
Lëvizja në tatimin e shtyrë (shënimi 23.1)	(99,668,281)	(25,854,158)
Tatim fitimi për vitin	**145,024,985**	**194,175,879**

23. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

23.2 Tatim fitimi (vazhdim)

Rakordimi midis normës efektive të tatimit dhe normës së përdorur për llogaritjen e fitimit për qëllime fiskale është paraqitur më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	
	Norma efektive	**Shuma**	**Norma efektive**	**Shuma**
Fitimi para tatimit		**1,117,252,020**		**1,506,478,449**
Taksa me normën 10% (2012: 10%)	10%	111,725,202	10%	150,647,845
Efekti i shpenzimeve të panjohura	3%	33,299,783	3%	43,528,034
Tatimi mbi fitimin për vitin	**13%**	**145,024,985**	**13%**	**194,175,879**

Një rakordim midis fitimit kontabël para llogaritjes së taksës dhe bazës për llogaritjen e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 është paraqitur si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Fitimi para tatimit	**1,117,252,020**	**1,506,478,449**
Plus: Rregullimet për qëllime të SNFR:		
Provigjone për llogari të dyshimta	774,882,752	95,960,132
Diferenca në normat dhe metodën e zhvlerësimit	203,144,413	166,629,081
Provigjone për detyrime koncesionare	47,233,853	41,470,064
Te tjera	6,234,414	-
Shtim i shpenzimeve të përllogaritura për personelin sipas SNRF	(34,821,623)	(45,517,697)
Fitimi fiskal para tatimit	**2,113,934,829**	**1,765,020,029**
Shpenzime të pazbritshme:		
Tarifa e koncensionit	291,668,111	393,348,163
Shpenzime të pajustifikuara	20,638,096	24,619,422
Gjoba dhe penalitete	8,213,595	5,435,896
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit	11,518,032	4,897,362
Shpenzime të përllogaritura	960,000	6,979,500
Fitimi i tatueshëm	**2,446,932,663**	**2,200,300,372**
Tatimi mbi fitimin 10% (2012: 10%)	**244,693,266**	**220,030,037**

24. INSTRUMENTAT FINANCIARË

24.1 Rreziku i kredisë

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2013 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Para në arkë dhe në bankë	1,862,598,841	1,658,970,177
Llogari të arkëtueshme, neto	1,728,515,382	2,467,001,167
Aktive të tjera	164,261,903	138,912,131
Totali	**3,755,376,126**	**4,264,883,475**

Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2013 sipas zonës gjeografike është:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Vendas	1,225,395,247	1,937,597,693
Të huaj	503,120,135	529,403,474
Totali	**1,728,515,382**	**2,467,001,167**

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit lidhet kryesisht me klientët për shërbime aeronautike dhe vetëm një shumë e vogël ka të bëjë me klientët tregtarë.

Provigjoni për llogari të dyshimta

Llogaritë e arkëtueshme,neto më 31 dhjetor 2013 janë detajuar më poshtë sipas vjetërsisë:

	31 dhjetor 2013	**31 dhjetor 2012**
Më pak se një vit	1,728,515,382	2,467,001,167
Më shumë se një vit	1,324,013,520	546,735,249
Minus: Provigjon për llogari të dyshimta	(1,324,013,520)	(546,735,249)
	1,728,515,382	**2,467,001,167**

Shoqëria provigjonon plotësisht të gjitha gjendjet më të vjetra se një vit. Lëvizjet në provigjonin për llogaritë e dyshimta paraqiten në shënimin 9.

24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

24.2 Rreziku i likuiditetit

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2013, sipas maturitetit janë detajuar më poshtë:

	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Vlera kontabël
Aktive financiare				
Parapagim i tatimit mbi fitimin	145,688,521	-	-	**145,688,521**
Llogari të arkëtueshme, neto	1,728,515,382	-	-	**1,728,515,382**
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	-	-	**-**
Aktive të tjera	164,261,903	-	-	**164,261,903**
Para në arkë dhe bankë	1,862,868,568	-	-	**1,862,868,568**
Totali i aktiveve financiare	**3,901,334,374**	**-**	**-**	**3,901,334,374**
Detyrime financiare				
Kredi bankare dhe hua të tjera	306,533,605	258,251,322	4,401,350,369	**4,966,135,296**
Detyrime të tjera	1,634,604,839	43,778,431	583,400,998	**2,261,784,268**
Llogari të pagueshme	99,240,137	-	-	**99,240,137**
Llogari të pagueshme ndaj palëve te lidhura	10,432	-	-	**10,432**
Tarifa e pagueshme e koncensionit	277,447,949	-	-	**277,447,949**
Totali i detyrimeve financiare	**2,317,836,962**	**302,029,753**	**4,984,751,367**	**7,604,618,082**
Ekspozimi	**1,583,497,412**	**(302,029,753)**	**(4,984,751,367)**	**(3,703,283,708)**
Kumulative	**1,583,497,412**	**1,281,467,659**	**(3,703,283,708)**	

24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

24.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2012, sipas maturitetit janë detajuar më poshtë:

	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Vlera kontabël
Aktive financiare				
Parapagim i tatimit mbi fitimin	149,670,770	-	-	**149,670,770**
Llogari të arkëtueshme, neto	2,467,001,167	-	-	**2,467,001,167**
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	8,642,994	-	-	**8,642,994**
Aktive të tjera	138,912,131	-	-	**138,912,131**
Para në arkë dhe bankë	1,659,175,026	-	-	**1,659,175,026**
Totali i aktiveve financiare	**4,423,402,088**	**-**	**-**	**4,423,402,088**
Detyrime financiare				
Kredi bankare dhe hua të tjera	295,515,193	242,287,548	4,888,826,902	**5,426,629,643**
Detyrime të tjera	1,473,605,147	43,587,955	663,055,393	**2,180,248,495**
Llogari të pagueshme	156,460,394	-	-	**156,460,394**
Tarifa e pagueshme e koncensionit	380,872,711	-	-	**380,872,711**
Totali i detyrimeve financiare	**2,306,453,445**	**285,875,503**	**5,551,882,295**	**8,144,211,243**
Ekspozimi	**2,116,948,643**	**(285,875,503)**	**(5,551,882,295)**	**(3,720,809,155)**
Kumulative	**2,116,948,643**	**1,831,073,140**	**(3,720,809,155)**	

24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

24.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekpozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2013 është si më poshtë:

	Euro	USD	Lek	Vlera kontabël
Parapagim i tatimit mbi fitimin	-	-	145,688,521	**145,688,521**
Llogari të arkëtueshme, neto	1,728,515,382	-	-	**1,728,515,382**
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	-	-	**-**
Aktive të tjera	14,284,242	-	149,977,661	**164,261,903**
Para në arkë dhe bankë	1,856,768,192	1,353,098	4,747,278	**1,862,868,568**
Totali i aktiveve monetare	**3,599,567,816**	**1,353,098**	**300,413,460**	**3,901,334,374**
Kredi bankare dhe hua të tjera	4,966,135,296	-	-	**4,966,135,296**
Llogari të pagueshme	38,203,946	2,511,811	58,524,380	**99,240,137**
Llogari të pagueshme ndaj palëve te lidhura	10,432	-	-	**10,432**
Detyrime të tjera	2,242,790,616	-	18,993,652	**2,261,784,268**
Tarifa e pagueshme e koncensionit	277,447,949	-	-	**277,447,949**
Totali i detyrimeve monetare	**7,247,140,290**	**2,511,811**	**77,518,032**	**7,327,170,133**
Ekspozimi neto	**(3,647,572,474)**	**(1,158,713)**	**222,895,428**	**(3,425,835,759)**

24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

24.3 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Ekpozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2012 është si më poshtë:

	Euro	USD	Lek	Vlera kontabël
Parapagim i tatimit mbi fitimin	-	-	149,670,770	**149,670,770**
Llogari të arkëtueshme, neto	2,467,001,167	-	-	**2,467,001,167**
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	8,642,994	-	-	**8,642,994-**
Aktive të tjera	14,284,242	-	124,627,889	**138,912,131**
Para në arkë dhe bankë	1,645,595,338	1,454,436	12,125,252	**1,659,175,026**
Totali i aktiveve monetare	**4,135,523,741**	**1,454,436**	**286,423,911**	**4,423,402,088**
Kredi bankare dhe hua të tjera	5,426,629,643	-	-	**5,426,629,643**
Llogari të pagueshme	47,998,929	8,500,019	99,961,446	**156,460,394**
Tarifa e pagueshme e koncensionit	2,125,932,528	-	54,315,967	**2,180,248,495**
Detyrime të tjera	380,872,711	-	-	**380,872,711**
Totali i detyrimeve monetare	**7,981,433,811**	**8,500,019**	**154,277,413**	**8,144,211,243**
Ekspozimi neto	**(3,845,910,070)**	**(7,045,583)**	**132,146,498**	**(3,720,809,155)**

24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

24.4 Rreziku ndaj normës së interesit

Në datën e raportimit instrumentat financiarë të Shoqërisë që kanë interes ishin:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Instrumentat me interes të ndryshueshëm		
Detyrime financiare	2,011,510,808	2,228,129,857
	2,011,510,808	**2,228,129,857**

Analiza e ndjeshmërisë së rrjedhës së parasë për instrumentat e ndryshueshëm

Një ndryshim prej 100 pikë në normat e interesit në datën e raportimit do të kishte rritur (zvogëluar) fitimin ose humbjen me shumat e paraqitura më poshtë. Kjo analizë supozon që të gjitha variablat e tjerë, veçanërisht normat në monedhë të huaj, mbeten të pandryshuar.

	Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	
	100 pikë Rritje	100 pikë Rënie
31 dhjetor 2013		
Instrumentat me norma të ndryshueshme	20,115,108	(20,115,108)
31 dhjetor 2012		
Instrumentat me norma të ndryshueshme	22,281,299	(22,281,299)

25. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij raporti nuk ka çështje të rëndësishme ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

Siç është paraqitur në shënimin 11, më 31 dhjetor 2013, Shoqëria ka një shumë 588,840 mijë Lek (2012: 628,155 mijë Lek), e cila përfaqëson para të vendosura në Llogarinë Rezervë të Shërbimit të Borxhit tek Raiffeisen Bank dhe paratë e vendosura në Llogarinë Rezervë të investimeve Kapitale tek Alpha Bank, Tirana Branch, siç është përshkruar në seksionin 5.16 (c) të Marrëveshjes së Ndryshuar për Kushtet e Përbashkëta.

26. PARAQITJE DHE PËRLLOGARITJE E VLERËS SË DREJTË

Vlera e drejtë e përllogariur e aktiveve dhe detyrimeve financiare përafron me vlerën neto të tyre në pasqyrën e pozicionit financiar për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose aplikimit të normave të interesit që përafrojnë me ato të tregut.

27. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas periudhës raportuese nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje që mund të kërkojë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.